



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 29 tetor 2021
Nr.ref.:RK 1880/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI171/20

Parashtrues

Jakup Ramadani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës Rev.nr.203/2020 i 23 shtatorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Jakup Ramadani nga Ferizaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev.nr.203/2020 i 23 shtatorit 2020 në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.2522/2016 i 4 dhjetorit 2016 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) C.nr.549/13 të 12 majit 2016.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 7 [Vlerat] 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe 121 [Prona] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 5 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 17 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi Gjyqtaren Selvetë Gërzhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 20 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe iu kërkuar që ta nënshkruajë formularin e dorëzuar në Gjykatë.
8. Më 20 nëntor 2020, një kopje e kërkesës iu dorëzua Gjykatës Supreme.
9. Më 1 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi formularin e nënshkruar.
10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

11. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21 , gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin Nr.KSh. KI171/20, duke e zëvendësuar Kryetaren paraprake Arta Rama-Hajrizi në rolin e saj si kryesuese në këtë Kolegj shqyrtues, me Gjyqtarin Radomir Laban.
13. Më 7 tetor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

14. Gjendja faktike në rastin konkret kërkon që procedurat e zhvilluara në etapa të ndryshme të ndahen në grupe të procedurave të zhvilluara në etapat përkatëse.

(i) procedurat e zhvilluara nga viti 1991 deri 2005

15. Nga dokumentet e dorëzuara rezulton se ndërmarrja për distribuimin e energjisë elektrike “Elektrokosova” nga Prishtina, distribucioni në Ferizaj më 02.02.1991 kishte nxjerrë vendim nr.273 për përjashtim nga puna të parashtruesit të kërkesës si dhe vendim nr.710 të 07.03.1991 të shkallës së dytë për refuzim të prapësimit të parashtruesit të kërkesës. Arsyetimi për largim nga puna të parashtruesit të kërkesës kishte qenë mos kryerja e detyrave të punës për një kohë të gjatë dhe ikja nga puna para përfundimit të orarit të punës.
16. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur padi kundër Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) lidhur me kompensimin e të ardhurave personale nga data 02.02.1991 deri më 30.03.1999, në shumën e përgjithshme prej 43.479.66 euro.
17. Më 7 korrik 2003, Gjykata Komunale në Ferizaj me Aktgjykim [C.nr.58/01] (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi si të kundërligjshme vendimet nr.273 dhe nr.710 të datave 02.02.1991 dhe 07.03.1991 të Elektrokovës-KEK për përjashtim nga puna të parashtruesit të kërkesës. Gjykata Komunale kishte konstatuar se pala e paditur nuk ka pasur asnjë argument nga i cili do të rezultonte se parashtruesi i kërkesës ka kryer cenimin e rëndë në detyrat e punës dhe se të gjitha veprimet e vendimet në lidhje me këtë kontest kanë qenë subjektive, diskriminuese ndaj parashtruesit të kërkesës dhe si të tilla janë të kundërligjshme.
18. Më 21 qershor 2004, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykim Ac.nr.591/2003, refuzoi ankesën e palës së paditur KEK dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale [C.nr.58/01] të 7 korrikut 2003. Gjykata e Qarkut në Prishtinë kishte konstatuar se gjykata komunale drejtë kishte zbatuar të drejtën materiale, kishte vërtetuar drejtë dhe plotësisht gjendjen faktike me konstatim se e paditura KEK ka legjitimitet pasiv.

19. Më 28 korrik 2005, Gjykata Supreme me Aktgjykim [Rev.nr.65/2005] e refuzoi të pabazuar revizionin e të paditurës KEK i paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut [Ac.nr.591/2003] të 21 qershorit 2004. Gjykata Supreme kishte vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët kanë vendosur drejtë kur kanë konstatuar se pushimi i marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës është i paligjshëm dhe se e paditura KEK ka legjitimitet pasiv.

(ii) procedurat e zhvilluara nga viti 2005 deri 2013

20. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës, kishte vazhduar me kërkesëpadinë e tij në Gjykatën Komunale në Ferizaj me ç 'rast ishte shprehur se pala e paditur i ka shkaktuar dëm duke e larguar puna dhe duke mos e lejuar të kthehet në punë tek pala e paditur KEK.
21. Më 15 shtator 2011, Gjykata Komunale në Ferizaj me Aktgjykim [C.nr.396/2005] kishte aprovuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe obliguar të paditurën KEK, që në emër të shpërblimit për të ardhura personale të përealizuara për periudhën kohore 02.02.1991 deri më 30.03.1999 në shumën e përgjithshme prej 43.479.66 euro.
22. Më 8 prill 2013, Gjykata e Apelit me Aktvendim CA.nr.2818/2012 kishte ndryshuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj [C.nr.396/2005] të 15 shtatorit 2011, duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin e gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale për faktin se padia e parashtruesit të kërkesës bazuar në nenin 376 të LMD-së ka arritur parashkrimin absolut për arsye se nga data e shkaktimit të dëmit të pretenduar, deri në paraqitjen e padisë në gjykatë kanë kaluar më tepër se 5 vite.
23. Më 22 korrik 2013, Gjykata Supreme me Aktvendim Rev. nr. 179/2013, kishte pranuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të bazuar dhe anuluar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [CA.nr.2818/2012] dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj [C.nr.396/2005] duke e kthyer lëndën në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

(iii) procedurat e zhvilluara nga viti 2013 deri 2020

24. Më 12 maj 2016, Gjykata Themelore me Aktgjykim C.nr.549/13, refuzoi në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës kundër të paditurës KEK lidhur me kompensimin e të ardhurave personale për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të të paditurës. Gjykata Themelore shpjegoi: (i) se palës së paditur KEK i mungon legjitimiteti pasiv sepse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit (parashtruesit të kërkesës); (ii) parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga Elektrokosova; (iii) pala e paditur KEK nuk ka kontinuitet juridik me subjektin e mëparshëm Elektrokosova, në të cilën parashtruesi i kërkesës kishte krijuar marrëdhënie pune; (iii) se pala e paditur KEK është regjistruar në regjistrin e përkohshëm të bizneseve të UNMIK-ut më 06.10.200; dhe, (iv) pala

e paditur KEK nuk ka legjitimitet pasiv sepse nuk ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës.

25. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta miratoj ankesën, aktgjykimin e goditur ta prish, apo aktgjykimin ta ndryshoj, ndërsa kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ta miratoj në tërësi të bazuar.
26. Më 4 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit me Aktgjykim Ac.nr.2522/2016 refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndërsa e vërtetoi aktgjykimin e gjykatës themelore C.nr.549/13 të 12 majit 2016. Gjykata e Apelit konstatoi: (i) aktgjykimi i kontestuar përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për faktet vendimtare; (ii) Gjykata Themelore drejtë ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendime të Elektrokosovës, nga ku rezulton se parashtruesit të kërkesës marrëdhënia e punës nuk i është ndërprerë nga pala e paditur KEK; dhe, (iii) pala e paditur KEK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim apo mosveprim për ndërprerjen e marrëdhënien e punës, pasi që nuk ka ekzistuar si subjekt juridik në kohën kur parashtruesit të kërkesës i është shkaktuar dëmi material si pasojë e largimit të kundërligjshëm nga puna.
27. Parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion kundër vendimeve të gjykatave të instancës më të ulët duke pretenduar se është i gabuar qëndrimi juridik i tyre kur kanë konstatuar se pala e paditur KEK nuk është pasardhës i Elektronomisë së Serbisë. Pala e paditur KEK në përgjigjen në revizion kishte propozuar që revizioni të refuzohet i pabazuar.
28. Më 23 shtator 2020, Gjykata Supreme me Aktgjykim [Rev. nr.203/2020] refuzoi të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.2522/2016 të 4 dhjetorit 2019. Gjykata Supreme konstatoi: (i) pala e paditur KEK nuk ka kontinuitet juridik me subjektin e mëparshëm Elektroekonomia e Serbisë sepse pas luftës është krijuar realitet i ri; (ii) pala e paditur KEK është regjistruar operator i ri i rrjetit energjetik më 06.10.2000 nën administrimin e UNMIK-ut; (iii) gjykatat e instancës më të ulët kanë gjykuar drejtë kur kanë konstatuar se pala e paditur KEK nuk mund të jetë përgjegjëse për pasojat e shkaktuara në kohën kur janë shkaktuar pasojat; dhe, se (iv) thëniet në revizion të parashtruesit të kërkesës se lidhur me çështjen konkrete është vendosur në vitin 2005 nga Gjykata Supreme dhe se nuk mund të vendoset sërish lidhur me këtë, nuk qëndrojnë nga arsyja se nuk kemi të bëjmë me palët e njëjta dhe çështjen e njëjtë dhe se qëndrimet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme në këtë drejtim janë të qarta dhe nuk ka divergjenca.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 7 [Vlerat] 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 121 [Prona] të Kushtetutës.

30. Parashtruesi i kërkesës pohon: *“Duhet të ceket se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Rev.nr.65/2005 i datës 28.07.2005 se ekziston kontinuiteti në mes të Elektrokosovës dhe të paditurës.”*
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *“në lidhje me legjitimitetin pasiv është vendosur njëherë sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me revizion Rev.nr.65/2005 i datës 28.07.2005 për të njëjtën çështje nuk mund të gjykohet.”*
32. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon: *“Duhet theksuar se aktgjykimet e lartshënuara nuk janë aktgjykime juridike por ato janë aktgjykime politike andaj në këtë rast mu kanë mohuar të gjitha të drejtat themelore për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

35. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*
36. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve, 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët parashohin:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

37. Në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr.203/2020] të 23 shtatorit 2020, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.
38. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
39. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) specifikon:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

40. Gjykata vëren se thelbi i ankesës së parashtruesit është se Gjykata Supreme nuk ka vendosur drejtë kur ka përcaktuar se pala e paditur KEK nuk është pasardhës i Elektrokosovës me ç’ rast atij i janë *“mohuar të gjitha të drejtat themelore për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.”* Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se çështja e tij është gjykuar njëherë nga Gjykata Supreme me Aktgjykim [Rev.nr.65/2005] të 28 korrikut 2005 dhe se nuk mund të “gjykohet dy herë.”
41. Gjykata në vijim, do të trajtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e

detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

42. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata Themelore kishte konstatuar: (i) se palës së paditur KEK i mungon legjitimiteti pasiv sepse nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit (parashtruesit të kërkesës); (ii) parashtruesit të kërkesës i është ndërprerë marrëdhënia e punës nga Elektrokosova; (iii) pala e paditur KEK nuk ka kontinuitet juridik me subjektin e mëparshëm Elektrokosova, në të cilën parashtruesi i kërkesës kishte krijuar marrëdhënie pune; (iii) se pala e paditur KEK është regjistruar në regjistrin e përkohshëm të bizneseve të UNMIK-ut më 06.10.2000; dhe, (iv) pala e paditur KEK nuk ka legjitimitet pasiv sepse nuk ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës parashtruesit të kërkesës. Këto konstatime më vonë në tërësi u miratuan dhe vërtetuan edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.
43. Gjykata po ashtu vëren se sa i përket pretendimit për çështje të gjykuar, Gjykata Supreme ishte përgjigjur: *"[...] thënie në revizion të parashtruesit të kërkesës se lidhur me çështjen konkrete është vendosur në vitin 2005 nga Gjykata Supreme dhe se nuk mund të vendoset sërish lidhur me këtë, nuk qëndrojnë nga arsyeja se nuk kemi të bëjmë me palët e njëjta dhe çështjen e njëjtë dhe se qëndrimet në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme në këtë drejtim janë të qarta dhe nuk ka divergjenca."*
44. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se çështja e suksedimit të Elektrokosovës nga KEK është çështje që përcaktohet nga gjykatat e rregullta në kuadër të detyrave dhe prerogativës së tyre për konstatim të gjendjes faktike dhe zbatim të ligjit material e procedural në rastet individuale dhe se në këtë drejtim nuk mund të thuhet se janë cenuar garancitë procedural nga neni 31 i Kushtetutës. Veç kësaj, gjykatat e rregullta kanë shpjeguar se nuk ka kontinuitet juridik sepse pala e paditur KEK është regjistruar operator i ri i rrjetit energjetik nën administrimin e UNMIK-ut më 06.10. 2000.
45. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se praktika e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi. (Shih, në këtë kontekst rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi të 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi. (Shih, rastet e Gjykatës KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për Papranueshmërisë i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).
46. Gjykata nuk vëren zbatim të dukshëm arbitrar të ligjit apo të fakteve, konkluzion qartazi të paarsyeshëm të procedurave apo edhe mungesë të marrëdhënies logjike ndërmjet fakteve të konstatuara dhe zbatimit të dispozitave ligjore përkatëse ndaj atyre fakteve. Në të vërtetë, nga vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë dhënë arsyetim të bollshëm lidhur me legjitimitetin pasiv të palës së paditur KEK dhe përse pala e paditur nuk është pasardhës i Elektrokosovës.

47. Gjykata thekson se në jurisprudencën e saj për çështje të ngjashme ka miratuar konstatimet dhe qëndrimet e Gjykatës Supreme që: (i) KEK-ut i mungon legjitimiteti pasiv, (ii) KEK nuk ka kontinuitet juridik me subjektin e mëparshëm Elektrokosova, dhe, se (iii) ky konstatim dhe qëndrim i Gjykatës Supreme nuk cenon garancitë procedurale nga neni 31 i Kushtetutës (shih rastet e Gjykatës Kushtetuese nr. KI40/18 *Parashtrues Hysen Idrizi*, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 majit 2018, paragrafët 32, 35, 37, 38; dhe po ashtu shih KI93/15 *Parashtrues Ahmet Tërnavaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 14 prillit 2016, paragrafët 43, 44, 46).
48. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011, paragrafi 29; KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 dhjetorit 2017, paragrafi 37; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 qershorit 2018, paragrafi 57).
49. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikë gjyqësore të GJEDNJ-së, që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale. (Shih rastet e Gjykatës KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 38; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58).
50. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
51. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerr masa kur vëren se një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83; dhe gjithashtu, rastet e Gjykatës KIO6/17, parashtrues *L. G.*

dhe pesë të tjerët, cituar më lart, paragrafi 40; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 59).

52. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se si ky interpretim i ligjit dhe konstatimi i fakteve është qartazi i gabuar apo arbitrar dhe të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrarë*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës.
53. Gjykata më tej rithekson se, në parim, interpretimi i ligjit është kompetencë e gjykatave të rregullta. Për më tepër, “*drejtësia*” që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së nuk është drejtësi “*substanciale*”, por drejtësi “*procedurale*”. Në terma praktik, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës. (Shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës nr. KI42/16 Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për Papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty).
54. Gjykata gjithashtu thekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta një kontest civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Shani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe KI142/15, *Parashtrues Habib Makiqi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
55. Gjykata në fund thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta vetvetiu nuk ngre pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (shih rastin e Gjykatës nr. KI118/18 *Parashtrues Eco Construction sh.p.k.*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe po ashtu shih, rastin e GJEDNJ-së *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; dhe, ndër të tjera, KI56/17, cituar më lart, paragrafi 42).
56. Nga sa më sipër, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.
57. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk trajtohet në kuadër të kërkesës individuale sepse përmban në vetvete parime kushtetuese të karakterit të përgjithshëm që nuk ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret.
58. Kurse sa i përket pretendimeve për shkelje të 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimi të Profesioneve] dhe 121 [Prona] të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk ngrenë ndonjë çështje tjetër që nuk është trajtuar në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës, dhe si të tilla, po ashtu duhet të refuzohen qartazi të pabazuara.

59. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 7 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani